



# **GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI**

**Gjashtëmuji i dytë 2018**

**BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Ndërmarrjeve.....	2
Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri.....	4
1- Organizimi dhe fusha e veprimit .....	4
2- Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë .....	7
3- Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve.....	13
4- Struktura e huasë .....	15
5- Ngarkesa e huasë .....	17
6- Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen .....	19

## Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Ndërmarrjeve

Vrojtimi i Gjendjes Financiare dhe Huamarrjes së Ndërmarrjeve kryhet që prej vitit 2010, me një frekuencë gjashtëmujore. Ky vrojtim u realizua në periudhën nëntor-dhjetor 2018, duke pasur në fokus zhvillimet në gjysmën e dytë të vitit 2018, ndërsa prishmëritë i referohen gjysmës së parë të vitit 2019. Në këtë vrojtim, u përfshi një kampion prej rreth 1308 ndërmarrjesh të vogla, të mesme dhe të mëdha, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Nga këto, 1102 ndërmarrje ose 84.3% e totalit morën pjesë në vrojtim, duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Vlerësimet janë bërë mbi bazën e numrit dhe klasifikimit përkatës të ndërmarrjeve që janë përgjigjur.

### • GJENDJA FINANCIARE

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018, *konkurrenca* dhe *gjetja e tregut* vlerësohen si faktorë të rëndësishëm kufizues për të tre grupet e ndërmarrjeve (të vogla, të mesme dhe të mëdha). Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2018, rëndësia e faktorit të konkurrencës është vlerësuar disi në rritje për ndërmarrjet e mesme, por në rënie nga dy grupet e tjera. Problematikat lidhur me *aksesin në financim* dhe *kostot e financimit*, gjithashtu vlerësohen në rritje nga ndërmarrjet e mesme, por në zbutje nga ndërmarrjet e **vogla dhe të mëdha**.

*Ecuria e shitjeve* vijon të vlerësohet në rritje gjatë gjashtëmujorit të dytë 2018 për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, dhe në rënie për ndërmarrjet e vogla, duke shfaqur përmirësim në krahasim me periudhat e mëparshme. Në linjë me ecurinë e shitjeve, ndërmarrjet e vogla vijnë të vlerësojnë *ulje të rezultatit financiar*, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kanë vlerësuar *rritje* të tij gjatë periudhës. Ecuria pozitive e nivelit të shitjeve dhe e rezultatit financiar është reflektuar edhe në *zgjerimin e veprimtarisë* së ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, ndërkohë që ndërmarrjet e vogla nuk kanë raportuar zgjerim gjatë periudhës. Pritjet e ndërmarrjeve të të gjitha madhësive *paraqiten pozitive* lidhur me shitjet, rezultatit financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë, por subjektet shprehen më pak optimiste në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla.

Gjatë periudhës, më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura e kanë financuar veprimtarinë e tyre përmes shitjeve (63.1% e ndërmarrjeve të vogla, 53.5% e ndërmarrjeve të mesme dhe 59.8% e ndërmarrjeve të mëdha). Huamarrja, si burim më vete apo i kombinuar, është përdorur nga 19.4% e ndërmarrjeve të mëdha, 17.8% e ndërmarrjeve të mesme dhe 14% e ndërmarrjeve të vogla. Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, përdorimi i huamarrjes si burim financimi ka rezultuar në rënie për ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, por në rritje për ndërmarrjet e vogla.

### • HUAMARRJA

Rreth 42.2% e totalit të ndërmarrjeve (464 ndërmarrje gjithsej) pohojnë se kanë një hua për të paguar. Kjo peshë ka shënuar një rënie të lehtë me 0.3 pikë përqindje (pp) krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2018.

Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve të vogla huamarrëse është rritur me 2.8 pp krahasuar me gjysmën e parë të vitit, ndërkohë që kjo peshë ka rezultuar në rënie respektivisht me 0.8 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha. Rreth 85.4% e totalit të ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar bankave për të siguruar hua, duke shënuar rënie në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Për totalin e burimeve formale (banka dhe institucione financiare), pesha e ndërmarrjeve huamarrëse arrin në 90.5%, duke mbetur e pandryshuar nga periudha e kaluar.

Qëllimet kryesore të huamarrjes së ndërmarrjeve janë kryerja e *investimeve afatgjata* (39% e ndërmarrjeve) dhe përballimi i *shpenzimeve korrente* (33% e ndërmarrjeve). Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, rezulton se pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për të kryer investime afatgjata ka rënë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Rreth 75% e ndërmarrjeve të vogla, 78.9% e ndërmarrjeve të mesme dhe 79.7% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të *përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes* për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2018, kjo peshë rezulton më e lartë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

Huamarrja e ndërmarrjeve kryhet vetëm në *monedhën vendase* për 46% të ndërmarrjeve të vogla, 49% të ndërmarrjeve të mesme dhe 36% të ndërmarrjeve të mëdha; ndërsa pjesa tjetër është në valutë (euro dhe/ose dollarë) dhe/ ose e kombinuar (lekë dhe valutë). Huamarrja në monedhën evropiane rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (53% e tyre), duke tejkaluar monedhën vendase, dhe më pak e preferuar nga ndërmarrjet e mesme (41.3%). Në rastin e ndërmarrjeve të vogla, peshat e ndërmarrjeve që kanë marrë hua në lekë dhe në euro kanë rezultuar pothuaj të njëjta.

Vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për 79.5% të totalit të ndërmarrjeve huamarrëse. Të analizuara sipas madhësisë, rezulton që ngarkesa e borxhit është më e lartë tek ndërmarrjet e mëdha, ku rreth 22.6% e tyre deklarojnë se vlera e huasë është e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (73.5%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të ndërmarrjes, dhe kjo peshë ka rënë me 1.8 pp krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës.

- **MARRËDHËNIA ME BANKAT**

*Procesi i huamarrjes nga bankat* vlerësohet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", ndërsa *rëndësia e marrëdhënies me bankat* vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme", në rritje gjatë periudhës për të tre grupet e ndërmarrjeve. Lidhur me elementet që vështirësojnë përfitimin e një kredie bankare, për ndërmarrjet, *kostoja e lartë* e kredisë vijon të cilësohet si elementi kryesor, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Lidhur me planifikimin e një huamarrjeje në të ardhmen afatshkurtër, rreth 49% e ndërmarrjeve të përgjigjura kanë deklaruar se *nuk ka asnjë mundësi* që të kërkojnë një kredi bankare në gjashtëmujorin e ardhshëm. Krahasuar me vrojtimin e kaluar, kjo peshë rezulton në rënie për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, dhe lehtësisht në rritje në rastin e ndërmarrjeve të vogla. Në rastin e ndërmarrjeve të mesme vihet re një rritje e peshës në grup të ndërmarrjeve që pohojnë se *ka pak mundësi* dhe *ka shumë mundësi* që të marrin kredi gjatë periudhës pasardhëse, duke dhënë sinjale për një rritje të kërkesës për kredi.

## Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri


**Karakteristikat e kampionit të vrojtuar.** Vrojtimi i Gjendjes Financiare dhe Huamarrjes së Ndërmarrjeve kryhet që prej gjashtëmujorit të dytë 2010, me një frekuencë gjashtëmujore. Fillimisht, ky vrojtım u hodh në terren me një kampion të përzgjedhur që përfshinte 700 ndërmarrjet me *turnover*-in më të lartë (ndërmarrje të mëdha). Më tej, në vitin 2016, kampioni u zgjerua në rreth 1200 ndërmarrje të mëdha, të mesme e të vogla, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin. Në gjashtëmujorin e dytë 2018, vrojtimi u realizua me një kampion total prej 1308 ndërmarrjesh, të shpërndara në 31 rrethe të vendit. Pjesa kryesore e këtyre ndërmarrjeve (78.6%) janë përqendruar në 5 rrethe të mëdha, përkatësisht në: Tiranë (53%), Durrës (13.2%), Fier (4.4%), Shkodër (4.4%) dhe Elbasan (3.6%). Lidhur me fillimin e veprimtarisë, rezulton se 9.4% e ndërmarrjeve kanë filluar të operojnë përpara vitit 2000, 16.2% në vitet 2000-2010 dhe 7.2% në 2011-2018. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve (rreth 67%) nuk e kanë dhënë këtë informacion. Në totalin e kampionit të përzgjedhur, 84.3% e ndërmarrjeve (1102 gjithsej) i janë përgjigjur pyetjeve të vrojtimit dhe analiza e rezultateve mbështetet në këto përgjigje.

*Në kushtet e një kampioni të zgjeruar, analiza e mëposhtme është organizuar kryesisht bazuar në ndarjen sipas madhësisë së ndërmarrjeve.*


### 1- Organizimi dhe fusha e veprimit

**1.1 Shpërndarja sektoriale dhe madhësia e ndërmarrjeve.** Për gjashtëmujorin e dytë 2018, në ndarjen sipas sektorëve, rreth 34% e ndërmarrjeve i përkasin sektorit të *industrisë*, 31% i përkasin sektorit të *shërbimeve*, 16% i përkasin sektorit të *ndërtimit* dhe 19% i përkasin sektorit të *tregtisë*. Sipas madhësisë (Grafik 1.1), rreth 19.5% e ndërmarrjeve klasifikohen si *ndërmarrje të vogla* (5-19 persona të punësuar), 19% si *ndërmarrje të mesme* (20-49 të punësuar), dhe 61.5% si *ndërmarrje të mëdha* (mbi 50 të punësuar). Në grupin e *ndërmarrjeve të vogla*, peshën kryesore e zënë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e shërbimeve (32%), ndjekur nga sektori i tregtisë (26%). Në grupin e ndërmarrjeve të mesme, peshën më të lartë e kanë ndërmarrjet e sektorit të industrisë (31%) dhe të shërbimit (27%), dhe në grupin e ndërmarrjeve të mëdha, peshën kryesore e zënë ndërmarrjet e sektorit të industrisë (39%) (Grafik 1.2).

**Grafik 1.1**



**Grafik 1.2**




Burimi: Banka e Shqipërisë.


**1.2 Sigurimi i lëndës së parë dhe shitja e produkteve.** Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (respektivisht rreth 59% dhe 52% e tyre) sigurojnë *mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit*. Krahasuar me periudhën paraardhëse (gjashtëmujori i parë 2018), ky tregues ka rënë me 1.2 pp për ndërmarrjet e vogla dhe me 4.3 pp për ndërmarrjet e mesme. Në të kundërt, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të mëdha (rreth 44%), sigurojnë vetëm *deri në 20% të lëndës së parë brenda vendit* (Grafik 1.3).

Shitja e produkteve të ndërmarrjeve të përgjigjura vijon të mbetet *kryesisht brenda vendit*, ku 78% e ndërmarrjeve të vogla, 77% e ndërmarrjeve të mesme dhe 55% e ndërmarrjeve të mëdha, kanë deklaruar se kanë shitur shumicën e produkteve në tregun vendas (mbi 80% të produktit). Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, ka pasur një rënie të lehtë (me 1 pp) të peshës së ndërmarrjeve të vogla që shesin produktet e tyre kryesisht brenda vendit, ndërkohë pesha e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha që deklarojnë një gjë të tillë ka qenë në rritje (respektivisht me 2 pp dhe 5 pp) (Grafik 1.4).

**Grafik 1.3**



**Grafik 1.4**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke i analizuar përgjigjet për çështjet e mësipërme sipas sektorëve, rezulton se sektori i ndërtimit ka një varësi më të madhe ndaj lëndës së parë të siguruar në vend - rreth 74.6% e ndërmarrjeve të këtij sektori siguron *mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit*. Pesha e këtyre ndërmarrjeve është rritur me 3.7 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 5.2 pp krahasuar me një vit më parë (6MII 2017). Nga ana tjetër, sektori i industrisë shfaq varësi më të ulët, ku 56% e ndërmarrjeve të këtij sektori sigurojnë vetëm 20% të lëndës së parë brenda vendit. Pesha e këtyre ndërmarrjeve ka rënë me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e parë të 2018-ës.

**Tabelë 1.1. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve dhe përqindjes së blerjes së lëndës së parë brenda vendit**


		Deri në 20%	20-50%	50-80%	Mbi 80%
<b>Industria</b>	<b>6MII 2016</b>	54.2%	7.8%	11.1%	26.9%
	<b>6MI 2017</b>	45.7%	12.4%	10.5%	31.4%
	<b>6MII 2017</b>	47.9%	8.1%	13.8%	30.2%
	<b>6MI 2018</b>	60.2%	8.1%	8.6%	23.0%
	<b>6MII 2018</b>	56.0%	4.8%	12.3%	26.9%
<b>Shërbimet</b>	<b>6MII 2016</b>	21.3%	6.2%	9.3%	63.2%
	<b>6MI 2017</b>	14.1%	3.8%	14.1%	67.9%
	<b>6MII 2017</b>	22.9%	5.6%	8.0%	63.5%

	6MI 2018	24.2%	5.2%	7.0%	63.6%
	6MII 2018	27.3%	4.9%	8.4%	59.3%
Ndërtimi	6MII 2016	5.8%	1.6%	16.2%	76.4%
	6MI 2017	5.8%	1.4%	13.9%	78.8%
	6MII 2017	8.7%	6.6%	15.3%	69.4%
	6MI 2018	6.1%	5.6%	17.3%	70.9%
	6MII 2018	2.8%	3.3%	19.3%	74.6%
Tregtia	6MII 2016	43.4%	7.6%	13.1%	35.9%
	6MI 2017	45.0%	10.4%	13.9%	30.7%
	6MII 2017	42.9%	13.6%	16.2%	27.2%
	6MI 2018	42.8%	10.6%	12.8%	33.9%
	6MII 2018	46.7%	13.2%	13.7%	26.4%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

**1.3- Elementet kufizuese në aktivitetin e ndërmarrjeve<sup>1</sup>.** Elementi i konkurrencës vijon të cilësohet nga të gjitha grupet e ndërmarrjeve si faktori më i rëndësishëm kufizues në aktivitetin e tyre edhe gjatë periudhës së vrojtuar. Krahasuar me periudhën paraardhëse, rëndësia e këtij faktori vlerësohet disi në rritje për ndërmarrjet e mesme, por në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha.

Grafik 1.5



Burimi: Banka e Shqipërisë.


<sup>1</sup> Ndërmarrjet kanë dhënë gjykimin e tyre mbi rëndësinë e disa problemeve të caktuara, për të cilat iu është kërkuar të bëjnë një vlerësim me shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është shkalla më e ulët dhe 10 është shkalla më e lartë e vështirësisë. Për të agreguar përgjigjet për secilën çështje të vlerësuar, është llogaritur një mesatare e ponderuar për të gjitha ndërmarrjet e përgjigjura, duke peshuar përgjigjet me shkallët e vlerësimit (1-10).

Gjetja e tregut, gjithashtu, vlerësohet si një tjetër faktor i rëndësishëm kufizues për të tre grupet e ndërmarrjeve, por vlerësimi mbi këtë faktor ka qenë në rënie gjatë periudhës së vrojtuar. Problematikat lidhur me aksesin në financim dhe kostot e financimit vlerësohen në rritje nga ndërmarrjet e mesme, por në zbutje nga ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha.

## 2- Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë

**2.1 Monedha e kryerjes së veprimtarisë.** Euroizimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme vijon të mbetet i ulët, ku përkatësisht 66% e ndërmarrjeve të vogla dhe 60% e atyre të mesme deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë *plotësisht* ose *kryesisht*<sup>2</sup> në monedhën vendase. Përdorimi i valutës është më i theksuar tek ndërmarrjet e mëdha, ku 37% e tyre deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë *kryesisht* ose *plotësisht në valutë*, dhe kjo peshë ka mbetur e njëjtë krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2018.

Grafik 2.1




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.2 Ecuria e shitjeve, rezultati financiar dhe zgjerimi i veprimtarisë.** Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2018, ndërmarrjet e vogla vijnë të raportojnë *rënie të nivelit të shitjeve* me një balancë neto negative prej -5.6%, por duke shfaqur përmirësim krahasuar me një gjashtëmujor më parë. Nga ana tjetër, situata ka rezultuar pozitive për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, të cilat kanë shënuar balanca neto pozitive të shitjeve, respektivisht me +18.6% dhe +23.4%, në rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por duke mbetur nën nivelet e një viti më parë (Grafik 2.2). Lidhur me *pritshtëritë për nivelin e shitjeve të përgjithshme* për gjashtëmujorin e ardhshëm, të tre grupet e ndërmarrjeve paraqiten optimiste, duke pritur një rritje të nivelit të shitjeve. Gjithsesi, subjektet janë shprehur më pak optimiste në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla (Grafik 2.3).

<sup>2</sup> Mbi 50% të veprimtarisë në lekë.




**Grafik 2.2**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 2.3**




Rezultatet ecin në mënyrë të ngjashme edhe për *ndryshimin e rezultatit financiar* në gjysmën e dytë të vitit 2018, duke ndjekur ecurinë e balancës së shitjeve të përgjithshme. Kështu, ndërmarrjet e vogla vijojnë të vlerësojnë *ulje të rezultatit financiar* për gjashtëmuajorin e dytë 2018, me një balancë neto negative -3.3%, por me ngushtim të kësaj balance në krahasim me periudhat e mëparshme. Nga ana tjetër, ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha deklarojnë balanca pozitive të rezultatit financiar të tyre, respektivisht +13.4% dhe +21.7%, duke shënuar përmirësim krahasuar me periudhën e kaluar, por duke mbetur nën nivelet e deklaruarra një vit më parë. *Pritshmëritë për gjashtëmuajorin e ardhshëm* janë pozitive për të gjitha ndërmarrjet, pra në favor të një rezultati financiar më të lartë, por më pak optimiste se në gjashtëmuajorin paraardhës. Ky rezultat shkon në të njëjtën linjë me pritshmëritë për ecurinë e shitjeve për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2019.

**Grafik 2.4**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafik 2.5**




Për sa i takon *zgjërimit të veprimtarisë* apo rritjes së investimeve për gjysmën e dytë të vitit 2018, me përjashtim të ndërmarrjeve të vogla, dy grupet e tjera të ndërmarrjeve kanë shënuar balanca neto pozitive - përkatësisht +11.0% për ato të mesme dhe +22.9% për ndërmarrjet e mëdha - duke mbështetur ecurinë e rezultatit financiar të tyre gjatë periudhës (Grafik 2.6). *Për gjashtëmuajorin e ardhshëm*, të gjitha ndërmarrjet presin një zgjerim të veprimtarisë së tyre, me një balancë neto pozitive. Në rastin e ndërmarrjeve të mëdha, pritet për një zgjerim të veprimtarisë kanë qenë optimiste dhe në rritje gjatë tre vrojtimeve të fundit, ndërkohë që tek ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, pritet paraqiten më pesimiste krahasuar me periudhën paraardhëse (Grafik 2.7).

Pritshmëritë përgjithësisht pozitive të ndërmarrjeve të të gjitha madhësive, lidhur me shitjet, rezultatit financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë së tyre, vijojnë dhënien e sinjaleve optimiste mbi ecurinë e veprimtarisë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, por me një rritëm më të moderuar.

**Grafik 2.6**



**Grafik 2.7**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.3 Niveli i shitjeve dhe rezultati financiar.** *Ecuria e agreguar e nivelit të shitjeve të përgjithshme* është analizuar nëpërmjet një indeksi<sup>3</sup>, i cili peshon përgjigjet e ndërmarrjeve sipas intervaleve të ndryshme, dhe duke i grupuar ato sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe sektorëve.


Në ndarjen sipas madhësisë, ecuria e vlerave të indeksit tregon një rritje të nivelit të shitjeve për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve (Grafik 2.8), por më e theksuar në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha. Rezultatet e indeksit sipas sektorëve tregojnë se vlerat më të larta të shitjeve janë realizuar nga sektori i tregtisë, ndërkohë që vlerat më të ulëta vijojnë të shënohen nga sektori i shërbimeve. Krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar, indeksi i shitjeve paraqet rritje për sektorët e industrisë, shërbimeve dhe ndërtimit, por rënie për sektorin e tregtisë (Grafik 2.9).

<sup>3</sup> Koeficientët e ponderimit sipas intervaleve të shitjeve janë: “Deri në 10 milionë lekë” = 0; “10-49 milionë lekë” = 0.25; “50-99 milionë lekë” = 0.5; “100-500 milionë lekë” = 0.75; “Mbi 500 milionë lekë” = 1. Rritja e vlerës së këtij indeksi nënkupton rritjen e nivelit të shitjeve të përgjithshme për ndërmarrjet.

**Grafik 2.8**




**Grafik 2.9**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket *rezultatit financiar* për gjashtëmujorin e dytë 2018, vetëm 725 ndërmarrje (ose rreth 55.4% e totalit të kampionit) kanë dhënë informacion mbi të. Në grupin e ndërmarrjeve të përgjigjura, mbi 90% e tyre, për secilën kategori madhësie, kanë raportuar *fitim* gjatë periudhës. Kjo peshë ka rezultuar më e lartë tek ndërmarrjet e mëdha (93.4%) dhe më e ulët tek ndërmarrjet e vogla (91.4%), por në rritje për të tre grupet e ndërmarrjeve, krahasuar me periudhën paraardhëse.


**Grafik 2.10**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Për ndërmarrjet të cilat raportojnë fitim, të tre grupet e ndërmarrjeve vlerësojnë rritje të shitjeve të përgjithshme dhe të rezultatit financiar, dhe pohojnë zgjerim të veprimtarisë apo rritje të investimeve (Grafik 2.11). Krahasuar me periudhën paraardhëse, balancat pozitive paraqiten të përmirësuar në rastin e nivelit të shitjeve dhe të rezultatit financiar për të tre grupet e ndërmarrjeve, por disi në rënie kur bëhet fjalë për zgjerimin e veprimtarisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ndërkohë, pritshmëritë për gjashtëmujorin e ardhshëm vijnë të jenë pozitive, por në rënie në krahasim me periudhën paraardhëse për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve (Grafik 2.12).

**Grafik 2.11**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 2.12**




Për ndërmarrjet të cilat raportojnë humbje, të tre grupet e ndërmarrjeve raportojnë balanca negative për nivelin e shitjeve të përgjithshme dhe të rezultatit financiar gjatë periudhës. Përsa i përket zgjerimit të veprimtarisë apo rritjes së investimeve, balanca neto ka rezultuar: pozitive në rastin e ndërmarrjeve të vogla; neutrale tek ndërmarrjet e të mëdha; dhe negative në rastin e ndërmarrjeve të mesme (Grafik 2.13). Pritshmëritë e ndërmarrjeve me humbje paraqiten pesimiste për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe atyre të mëdha (Grafik 2.14).

**Grafik 2.13**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafik 2.14**



**2.4 Financimi i veprimtarisë.** Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2018, më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura kanë vijuar të financojnë veprimtarinë e tyre përmes shitjeve (63.1% e ndërmarrjeve të vogla, 53.5% e ndërmarrjeve të mesme dhe 59.8% e ndërmarrjeve të mëdha). Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2018, mbështetja vetëm në këtë burim është rritur për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha dhe ka mbetur pothuaj e pandryshuar për ndërmarrjet e vogla. Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit vazhdon të zërë një peshë të konsiderueshme, por në rënie, për të gjitha llojet e

ndërmarrjeve. Kombinimet më të përdorura vijojnë të mbeten ato mes shitjeve dhe huasë, apo shitjeve dhe financimit me burime të brendshme (rezervat e mbartura, rritje kapitali) (Grafik 2.15).


**Grafik 2.15**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Huamarrja si burim financimi (më vete apo i kombinuar me burime të tjera) është përdorur nga 19.4% e totalit të ndërmarrjeve të mëdha, 17.8% e ndërmarrjeve të mesme dhe 14% e ndërmarrjeve të vogla. Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, përdorimi i huamarrjes si burim financimi rezultoi në rënie për ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, dhe në rritje për ndërmarrjet e vogla (Grafik 2.16).

**Grafik 2.16**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 3- Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve

Rreth 42.2% e totalit të ndërmarrjeve që janë përgjigjur<sup>4</sup> (gjithsej 465 ndërmarrje) pohojnë që kanë një hua për të paguar dhe kjo peshë ka shënuar një rënie të lehtë (me 0.3 pp) krahasuar me vërtetimin e gjashtëmujorit të parë 2018. Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve të vogla huamarrëse është rritur krahasuar me gjysmën e parë të vitit (me 2.8 pp), ndërkohë që kjo peshë ka rezultuar në rënie respektivisht me 0.8 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha (Tabela 3.1). Në ndarjen sipas sektorëve, pesha më e lartë e ndërmarrjeve huamarrëse rezulton në sektorin e tregtisë (56.1%), ndjekur nga sektori i ndërtimit (45.3%). Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse në të dy këta sektorë ka qenë në rënie krahasuar me periudhën e kaluar.

**Tabela 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe huamarrjes**

Ndërmarrjet huamarrëse sipas madhësisë	Nr. i ndërmarrjeve		Pesha ndaj totalit të grupit	
	6MI-2018	6MII-2018	6MI-2018	6MII-2018
<b>Të vogla</b>	67	77	33.0%	35.8%
<b>Të mesme</b>	93	95	46.0%	45.2%
<b>Të mëdha</b>	312	293	44.1%	43.3%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza e mëposhtme është realizuar duke u mbështetur vetëm mbi përgjigjet e ndërmarrjeve huamarrëse.


**3.1 Burimi i huasë.** Ndërmarrjet deklarojnë se i janë drejtuar kryesisht sektorit bankar si burim huamarrjeje (85.4% e totalit) dhe kjo peshë ka shënuar një rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë (respektivisht me rreth 3 pp dhe 6 pp). Të ndara sipas madhësisë, 79.1% e ndërmarrjeve të vogla, 91.2% e atyre të mesme dhe 85.1% e ndërmarrjeve të mëdha, kanë përfituar hua vetëm nga bankat. Në terma 6-mujorë, pesha e numrit të ndërmarrjeve huamarrëse nga bankat duket se është rritur vetëm në rastin e ndërmarrjeve të mesme, ndërkohë që ka mbetur e pandryshuar për ndërmarrjet e vogla dhe në rënie për ato të mëdha. Në terma vjetorë, këto pesha kanë qenë në rënie për të tre grupet e ndërmarrjeve. Përveç bankave, një pjesë e ndërmarrjeve i janë drejtuar institucioneve financiare jobanka (4.7% për ndërmarrjet e vogla dhe 1% për ndërmarrjet e mëdha), burimeve informale ose kombinimit të disa burimeve njëkohësisht. Në këtë aspekt, huamarrja informale si burim *më vete apo i kombinuar* është përdorur nga 16.3% e ndërmarrjeve të vogla, 7.0% e ndërmarrjeve të mesme dhe 13.4% e ndërmarrjeve të mëdha.

**3.2 Qëllimi i huasë.** Huamarrja e ndërmarrjeve përdoret kryesisht për të përballuar kryerjen e investimeve afatgjata (39% e ndërmarrjeve të përgjigjura) dhe për përballimin e shpenzimeve korrente (33% e ndërmarrjeve të përgjigjura). Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, rezulton se pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për të kryer investime afatgjata, ka rezultuar në rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Në të kundërt, pesha e ndërmarrjeve që deklarojnë huamarrje me qëllim *përballimin e shpenzimeve afatshkurtra*, ka rezultuar në rënie për të gjithë llojet e ndërmarrjeve. Një pjesë e konsiderueshme e ndërmarrjeve deklarojnë se kanë marrë hua për *më tepër se një qëllim*, duke kombinuar njëkohësisht disa burime. Ndërkohë, vërehet që huamarrja për të shlyer një hua më të vjetër - gjë që nënkupton rinegociim apo ristrukturim të huasë/ve ekzistuese - ka vijuar të shënojë rritje krahasuar me

<sup>4</sup> Duke marrë në konsideratë kampionin e plotë prej 1308 ndërmarrjesh, 35.6% e tyre pohojnë se janë huamarrëse, 48.7% deklarojnë që nuk kanë një hua për të paguar, dhe 15.7% e tyre nuk janë përgjigjur.

periudhën paraardhëse në rastin e ndërmarrjeve të mëdha, por ka shfaqur prirje rënëse tek ndërmarrjet e mesme dhe ato të vogla.


**Grafik 3.1**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**3.3 Mjaftueshmëria e huasë.** Rreth 75% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 79% e atyre të mesme dhe 79.7% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë dhe këto pesha janë rritur krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Pjesa tjetër e përgjigjeve ka rezultuar në balanca neto pozitive për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, ndërkohë që paraqitet negative për ndërmarrjet e vogla. Kjo tregon se pesha e ndërmarrjeve që do të preferonin më shumë hua është më e ulët se pesha e atyre që do të preferonin më pak hua për financimin e veprimtarisë, në rastin e ndërmarrjeve të vogla, duke sinjalizuar një rënie të kërkesës për hua për këto ndërmarrje. E kundërta ka rezultuar në rastin e balancave neto për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, gjë që mund të sinjalizojë një kërkesë më të lartë për hua të tyre.

**Grafik 3.2**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 4- Struktura e huasë

**4.1 Monedha.** Përsa i përket monedhës së huamarrjes së ndërmarrjeve, rezulton se gjatë periudhës 46% e ndërmarrjeve të vogla, 49.3% e ndërmarrjeve të mesme dhe 35.7% e ndërmarrjeve të mëdha, deklarojnë se huaja e tyre është vetëm në monedhën vendase, ndërsa pjesa tjetër është në valutë (euro dhe/ose dollarë) dhe/ose e kombinuar (lekë dhe valutë). Huamarrja në monedhën evropiane rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (53% e tyre), duke tejkaluar monedhën vendase, dhe më pak nga ndërmarrjet e mesme (41.3% e tyre). Në rastin e ndërmarrjeve të vogla, peshat e ndërmarrjeve që kanë marrë hua në lekë dhe në euro kanë rezultuar pothuaj të njëjta. Huamarrja në dollarë amerikanë zë një peshë të vogël dhe rezulton më e lartë për ndërmarrjet e vogla (rreth 1.6%).

**Grafik 4.1**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**4.2 Marrja e huasë dhe afati i maturimit.** Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve kanë marrë hua në 1-5 vitet e fundit - përkatësisht 49.3% e ndërmarrjeve të vogla, 48.4% e ndërmarrjeve të mesme dhe 49.6% e ndërmarrjeve të mëdha. Të tre këto peshat kanë qenë në rënie krahasuar me një gjashtëmujor më parë (respektivisht me 2.2 pp, 2.7 pp dhe 0.4 pp), por në rritje në terma vjetorë për ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha (respektivisht me 6.8 pp dhe 6.4 pp). *Huamarrja e re*, që nënkupton huamarrjen në gjashtë muajt e fundit, deklarohet vetëm nga 10.7% e ndërmarrjeve të vogla, 6.5% e ndërmarrjeve të mesme dhe 8.9% e ndërmarrjeve të mëdha. Peshat e huamarrësve të rinj ka vijuar të rritet në rastin e ndërmarrjeve të vogla, si në terma gjashtëmujorë dhe në terma vjetorë, ndërkohë që ka rezultuar në rënie për dy grupet e tjera të ndërmarrjeve. *Qëllimi kryesor i përdorimit të huamarrjes së re* vijon të mbetet “përballimi i shpenzimeve korrente” (për 33 % të totalit të ndërmarrjeve) dhe “kryerja e një investimi afatgjatë” (për 39% të totalit të ndërmarrjeve). Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, peshat e ndërmarrjeve që kanë marrë hua të re për të përballuar shpenzimet korrente ka qenë në rënie, ndërkohë që peshat e atyre që kanë marrë hua të re për të kryer një investim afatgjatë rezultojnë në rritje. Kjo prijë vëhet re tek të tre grupet e ndërmarrjeve, por më e theksuar është tek ato të mesme dhe të mëdha. Afati mesatar i mbetur i huamarrjes ka rezultuar 60.9 muaj për ndërmarrjet e vogla, 60.7 muaj për ndërmarrjet e mesme dhe 63.3 muaj për ato të mëdha.




**4.3 Norma e interesit të huasë dhe mënyra e shlyerjes.** Lloji i normës së interesit të huasë më të madhe ekzistuese<sup>5</sup>, mbetet *normë e pandryshueshme deri në fund të afatit* për 70.7% të ndërmarrjeve të vogla, 75.5% të atyre të mesme dhe 65.2% të atyre të mëdha. Nga ana tjetër, pesha e ndërmarrjeve që deklarojnë normë interesi të ndryshueshme çdo vit, ka shënuar një vlerë prej 22.7% për ndërmarrjet e vogla, 14.9% për ndërmarrjet e mesme dhe 24.1% për ndërmarrjet e mëdha. Gjatë periudhës, pesha e ndërmarrjeve që raportojnë hua me *normë të pandryshueshme interesi* ka rënë krahasuar me periudhën e kaluar, dhe kjo është kompensuar me rritjen e peshës së ndërmarrjeve që raportojnë hua me interesa të ndryshueshme çdo vit. Kjo prirje ka karakterizuar huamarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha. Frekuenca e shlyerjes është kryesisht mujore për 81.1% të ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 87.2% e ndërmarrjeve të mesme dhe 81% të ndërmarrjeve të mëdha.

**4.4 Forma e kolateralit dhe raporti i mbulimit.** Rreth 79.5% e ndërmarrjeve të vogla, 77.7% e ndërmarrjeve të mesme dhe 76.8% e atyre të mëdha, deklarojnë se huaja e marrë është e kolateralizuar vetëm me pasuri të paluajtshme, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve ka përdorur forma të tjera kolateralizimi<sup>6</sup>. Nëse do merrnim parasysh edhe kombinimin me forma të tjera kolateralizimi, pasuritë e paluajtshme janë përdorur prej 84.9% të ndërmarrjeve të vogla, 87.2% të ndërmarrjeve të mesme dhe 87.0% të atyre të mëdha (Grafik 4.1). Ndërkohë, 9.6% e ndërmarrjeve të vogla, 8.5% e ndërmarrjeve të mesme dhe 7.4% e ndërmarrjeve të mëdha, pohojnë se nuk kanë asnjë formë kolateralizimi. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, pesha e ndërmarrjeve me hua të pakolateralizuar ka shënuar rritje në grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe ka mbetur pothuaj e pandryshuar në dy grupet e tjera.


*Mbulimi i agreguar me kolateral* vlerësohet përmes indeksit të peshuar të përgjigjeve<sup>7</sup> (Grafik 4.2). Për gjashtëmujorin e dytë 2018, indeksi ka rezultuar 0.66 për ndërmarrjet e vogla, 0.63 për ndërmarrjet e mesme dhe 0.64 për ato të mëdha, duke rezultuar në një rënie të raportit të mbulimit për të tre llojet e ndërmarrjeve, si në terma 6-mujorë dhe në terma vjetorë.

**Grafik 4.2**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 4.3**



<sup>5</sup> Në rastin e ndërmarrjeve të cilat kanë më shumë se një hua.


<sup>6</sup> Mjete financiare, dorëzani, garanci të tjera, së bashku me kombinimin e disa formave kolateralizimi, përfshirë edhe kombinimin me pasuritë e paluajtshme.

<sup>7</sup> Ky indeks merr vlera nga 0 në 1 dhe rritja e vlerës së tij tregon rritje të peshës së mbulimit me kolateral. Koeficientët e peshimit të këtij indeksi, sipas alternativave, janë: "deri në 50% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.25; "50-100% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.5; "100-120% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.75; "mbi 120% të huasë së kolateralizuar" = 1.

## 5- Ngarkesa e huasë

**5.1 Vlera e huasë ndaj kapitalit.** Vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për 79.5% të ndërmarrjeve huamarrëse. Të analizuara sipas madhësisë, rezulton që ngarkesa e borxhit është më e lartë tek ndërmarrjet e mëdha, rreth 22.6% e të cilave deklarojnë se vlera e huasë është e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit. Duke i analizuar rezultatet e përgjigjeve sipas sektorëve, rezulton se gjatë periudhës, sektori i tregtisë ka peshën më të lartë të ndërmarrjeve që kanë një ngarkesë huaje mbi vlerën e kapitalit të ndërmarrjes, i ndjekur nga sektori i industrisë.

**Grafik 5.1**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Tabelë 5.1**

**Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje më të lartë se kapitali, sipas sektorëve**

	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
<b>6MI 2016</b>	11%	7%	8%	9%
<b>6MI 2017</b>	7.9%	15.7%	5.8%	13%
<b>6MII 2017</b>	10.2%	11.9%	7.3%	8.3%
<b>6MI 2018</b>	10.3%	6.3%	4.3%	6.7%
<b>6MII 2018</b>	7.7%	5.0%	6.3%	10.2%


**5.2 Shpenzimi për pagesën e huasë.** Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (73.5%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të ndërmarrjes, dhe kjo peshë ka rënë me 1.8 pp krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës.

**Grafik 5.2**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafik 5.3**



Barra e pagesës së huasë duket se rëndon më tepër tek ndërmarrjet e vogla, ku numri i ndërmarrjeve që raportojnë se kjo pagesë tejkalon 20% të të ardhurave zë rreth 33% të totalit të grupit<sup>8</sup>. Për ndërmarrjet e mesme, kjo peshë është 24%, ndërsa për ato të mëdha 25.5% (Grafik 5.2). Të tre këto pesha kanë ardhur në rritje krahasuar me vrotimin e kaluar. Të pyetura nëse *kostoja e shërbimit të huasë ka ndryshuar* gjatë gjashtëmujorit të kaluar, rreth 90.7% e ndërmarrjeve të vogla, 92.6% e ndërmarrjeve të mesme dhe 90% e ndërmarrjeve të mëdha, pohojnë që ky shpenzim ka mbetur *i pandryshuar*. Përgjigjet e pjesës tjetër të ndërmarrjeve kanë rezultuar në balanca neto pozitive për të tre grupet e ndërmarrjeve, duke treguar një rritje të këtij shpenzimi (Grafik 5.3). Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, kjo balancë ka rezultuar në rënie për ndërmarrjet e vogla, ndërkohë që ka qenë në rritje për ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha.

**5.3 Përballimi i koston së huasë.** Në rastin e rritjes së koston së shërbimit të huasë: në 41.2% të rasteve ndërmarrjet janë mbështetur *në uljen e shpenzimeve të tjera*; në 26.5% të rasteve deklarojnë se kanë *përdorur rezerva të ndryshme*; dhe në 26% të rasteve kanë *kombinuar disa mënyra njëkohësisht*. Duke e analizuar përballimin e rritjes së kostove të huasë sipas madhësinë së ndërmarrjeve, rezulton se ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kanë përdorur uljen e shpenzimeve si mënyrë kryesore (respektivisht 57% e ndërmarrjeve të vogla dhe 40% e ndërmarrjeve të mëdha), ndërsa shumica e ndërmarrjeve të vogla (57% e tyre) kanë kombinuar uljen e shpenzimeve me uljen e çmimeve dhe përdorimin e rezervave të ndryshme.

**Grafik 5.4**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**5.4 Pritshmëritë për pagesën e këstit të huasë për gjashtëmujorin e ardhshëm.** Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (mbi 87%), pavarësisht madhësisë së tyre, nuk presin ndryshim të këstit të huasë në gjashtëmujorin e ardhshëm (6MI 2019) dhe kjo peshë është rritur me 2 pp krahasuar vrotimin e kaluar. Për sa i përket pjesës së ndërmarrjeve që presin ndryshim të këstit, rezulton se të tre grupet e ndërmarrjeve presin rënie të tij gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, por më optimiste në këtë aspekt janë shprehur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

**Grafik 5.5**


<sup>8</sup> Llogaritur si shumë e peshave të përgjigjeve: “20-50% të të ardhurave”; “50-80% të të ardhurave”; dhe “mbi 80% të të ardhurave”.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**5.5 Ngarkesa në borxh** e ndërmarrjeve huamarrëse vlerësohet në rritje gjatë periudhës krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, ku vlera e indeksit për totalin e ndërmarrjeve është rritur nga 0.58 (6MI 2018) në 0.60 (6MII 2018). Në këtë aspekt, më të rënduara ndihen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe më pak ato të mëdha. Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, indeksi i ngarkesës në borxh ka shënuar rritje për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme, dhe ka mbetur i pandryshuar në rastin e ndërmarrjeve të mëdha.

**Grafik 5.6**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


*Shënim:* Indeksi llogaritet duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve, sipas koeficientëve që marrin vlerat: 1 për alternativën "ngarkesë e lartë"; 0.5 për alternativën "ngarkesë mesatare"; dhe 0 për alternativën "ngarkesë e ulët".

## 6- Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen

Pyetjet e kësaj rubrike i janë drejtuar të gjithë kampionit të ndërmarrjeve, përfshirë edhe ato johuamarrëse.

**6.1 Aksesi në financim.** Kërkesa e ndërmarrjeve për kredi vijon të mbetet e ulët, ku vetëm 7.7% e tyre deklarojnë se kanë aplikuar për financim gjatë gjashtëmujorit të fundit, dhe kjo peshë ka rënë me 3 pp krahasuar me vërtetimin e kaluar. Duke e analizuar këtë tregues sipas madhësisë së ndërmarrjeve, rezultojnë se peshën më të lartë të aplikimit për kredi vijojnë ta kenë ndërmarrjet e mëdha (9.5%). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, konstatohet një rënie e kërkesës për kredi nga të tre grupet e ndërmarrjeve (Grafik 6.1).

**Grafik 6.1**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për hua, në shumicën e rasteve, pohojnë se nuk e kanë të nevojshme për veprimtarinë që kryejnë, dhe peshën e kësaj kategorie rezultojnë më e lartë tek ndërmarrjet e mëdha. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve kanë vendosur të mos aplikojnë, për shkak se procesi u duket i vështirë dhe kjo pohohet më shpesh nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (Grafik 6.2).

Gjatë periudhës, peshën e ndërmarrjeve që pohojnë se nuk e kanë të nevojshme huamarrjen për veprimtarinë që kryejnë ka rezultuar pothuaj e njëjtë me gjashtëmujorin e kaluar, për të tre grupet e ndërmarrjeve. Nga ana tjetër, ka një rritje në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, të peshës së ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mëdha që e konsiderojnë huamarrjen si një proces të vështirë.


**Grafik 6.2**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të pyetur se si do të vepronin nëse nuk do të financoheshin nga bankat, pjesa kryesore e ndërmarrjeve të vogla (54.5%), atyre të mesme (44%) dhe të mëdha (41.1%), pohojnë se do të merrnin hua nga burime alternative, dhe këto pesha janë rritur krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Ndërkohë, rreth 39.8% e ndërmarrjeve të mëdha, 34% e ndërmarrjeve të mesme dhe 28% e atyre të vogla, kanë deklaruar se do të riaplikonin në një bankë apo institucion tjetër financiar. Ndërkohë që, krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë ka mbetur pothuaj e pandryshuar për ndërmarrjet e mëdha, ajo ka shënuar rënie në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla (respektivisht me 3 pp dhe 2 pp). Gjatë periudhës, duket se përqindja e ndërmarrjeve që pohojnë se do t'i shtyjnë në kohë planet e tyre për zgjerim ka rënë krahasuar me vrojtimin e kaluar, për të tre grupet e ndërmarrjeve.


**Grafik 6.3**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**6.2 Procesi i huamarrjes dhe marrëdhënia me bankat.** *Indeksi i vështirësisë së procesit të huamarrjes nga bankat*, për gjashtëmujorin e dytë 2018, vijon të mbetet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", për të tre grupet e ndërmarrjeve. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të 2018-ës, niveli i vështirësisë rezulton në zbutje për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, por disi në rritje për ndërmarrjet e mesme.


**Grafik 6.4**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Indeksi<sup>9</sup> i rëndësisë së marrëdhënies me bankat ka vijuar të vlerësohet midis nivelit “e rëndësishme” dhe “e domosdoshme”. Ecuria e këtij indeksi, gjatë periudhës, tregon për një rritje të dukshme të rëndësisë së marrëdhënies me bankat për ecurinë e veprimtarisë së të tre grupeve të ndërmarrjeve.

**Grafik 6.5**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>9</sup> Ky indeks llogaritet në mënyrë të ngjashme me indeksin e vështirësisë së huamarrjes nga bankat, ku koeficientët e peshimit për alternativat e dhëna janë: “jo edhe aq e rëndësishme” = 0; “e rëndësishme” = 0.5; “e domosdoshme” = 1.

**6.3 Vështirësia e përfitimit të huasë<sup>10</sup>.** *Kosto e kredisë* vijon të konsiderohet si elementi kryesor që vështirëson përfitimin e një huaje bankare, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në vijim të kostos së kredisë, për të tre grupet e ndërmarrjeve, edhe *kostoja e plotësimit të kërkesave të bankës* vijon të konsiderohet një vështirësi e konsiderueshme, ndjekur nga vlerësimi i *kushteve për garantimin e kredisë* dhe *paqartësia e kërkesave të bankës apo procedurat burokratike*. Krahasuar me vrojtimin e kaluar, të tre grupet e ndërmarrjeve i kanë vlerësuar në rritje elementet kufizuese të lartpërmendura, në përfitimin e një huaje.

**Grafik 6.6**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>10</sup> Për të vlerësuar vështirësinë e përfitimit të një huaje bankare, ndërmarrjeve iu është kërkuar të japin gjykimin e tyre për një sërë elementesh cilësore, sipas një sistemi vlerësimi me 5 shkallë, ku shkalla më e ulët e vështirësisë është 1 dhe shkalla më e lartë është 5. Për të marrë një vlerësim mesatar për secilin element cilësor, shkallët e vlerësimit nga 1 në 5 peshohen me peshat e përgjigjeve të dhëna nga ndërmarrjet.




**6.4 Planifikimi i huamarrjes.** Rreth 49% e ndërmarrjeve të përgjigjura kanë deklaruar se “nuk ka asnjë mundësi” që të kërkojnë një kredi bankare në gjashtëmujorin e ardhshëm. Krahasuar me vrotimin e kaluar, kjo peshë rezulton në rënie për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, dhe lehtësisht në rritje në rastin e ndërmarrjeve të vogla (Grafik 6.7). Ndërkohë, në rastin e ndërmarrjeve të mesme, vihet re një rritje e peshës në grup e ndërmarrjeve që pohojnë se “ka pak mundësi” dhe “ka shumë mundësi” që të marrin kredi gjatë periudhës pasardhëse, duke dhënë sinjale për një rritje të kërkesës për kredi nga ky lloj ndërmarrjesh. Kjo pririje është reflektuar dhe në vlerat e *Indeksit të vlerësimit të planifikimit të huamarrjes për gjashtëmujorin e ardhshëm*<sup>11</sup>. Krahasuar me periudhën e kaluar, ky indeks ka shënuar rënie për ndërmarrjet e vogla, ka mbetur i pandryshuar për ndërmarrjet e mëdha dhe është rritur dukshëm në rastin e ndërmarrjeve të mesme, duke konfirmuar gatishmëri më të lartë të tyre për huamarrje gjatë gjysmës së parë të vitit 2019.

**Grafik 6.7**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 6.8**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa për kredi reflektohet njëkohësisht dhe në vlerësimin e ndërmarrjeve lidhur me nivelin aktual të huamarrjes së tyre. Kështu, rreth 75% e ndërmarrjeve të vogla, 78.9% e ndërmarrjeve të mesme dhe 79.7% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2018, kjo peshë rezulton më e lartë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

<sup>11</sup>Për të vlerësuar përgjigjet e ndërmarrjeve është ndërtuar indeksi mbi planifikimin e huamarrjes, llogaritur duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve sipas një koeficienti, i cili rritet me rritjen e mundësisë së huamarrjes. Koeficientët për alternativat e dhëna janë: “nuk ka asnjë mundësi” = 0.25; “ka pak mundësi” = 0.5; “ka shumë mundësi” = 0.75; “është e sigurtë” = 1.